

### Atraksionet turistike në komunën e Vushtrrisë

Nr.	Emërtimi	Përshkrimi i atraksionit	Kategoria	Adresa	Komuna
1	Kalaja e vjetër e Vushtrrisë	Është ndër monumentet më të vjetra të Vushtrrisë. Kalaja sipas mënyrës së ndërtimit, përbërjes, materialit ndërtimor dhe të dhënave tjera të shkencave ndihmëse të historisë, është Iliro-Dardane, e rindërtuar në mesjetë. Ndërtimi është bërë nga guri me formë të ç'rregullt dhe janë lidhur me gëlqere të shuar. Sipërfaqja e kalasë është rreth 1.100m <sup>2</sup> . Pjesa e kalasë është edhe pyrgu me sipërfaqe rreth 1002. Muret e kalasë janë të larta 10-12m. Trashësia e mureve është 3-4m. Në kala hyrja nga pjesa J-L e saj. Kalaja kishte gypat e kanalizimit të cilët shërbenin për përcjelljen e mbeturinave dhe të ujit. Gjatë gërmimit, me rastin e ndërtimit të rrugës, poshtë nga qeshmja e kalasë janë gjetur gypa me diametër rreth 40cm, të cilët e kanë përcjellur ujin nga qeshmja e ndoshta edhe nga kalaja.	Atraksion kulturor	Vushtrri	Vushtrri
2	Ura e Gurit	Ura e Gurit gjendet mbi shtratin e thatë të lumit Sitnicë, uji i të cilit e ka ndërruar rrjedhën për disa dhjetëra m në perëndim. Dominojnë mendimet se ajo është ndërtuar në kohën e Perandorisë Osmane apo edhe më herët në kohën e perandorisë Romake. Në urë kanë qenë disa mbishkrime latine të cilat punëtorët shkencor të Beogradit i kanë gdhendur dhe i kanë hequr nga aty. Gurët janë të gjatë rreth një metër dhe të trashë 30-40cm. Të gdhendur mirë dhe të murosur me rëndë paralele. Ura me pjesë shtesë anësore është e gjatë rreth 135m dhe e gjerë rreth 6m e me nëntë harqe. Qemerët e urës janë të ndërtuar me gurë dyngjyrëshe të kombinuar bardh e kuq. Për lidhje më të mirë të tyre, në fugat ndarëse është përdorur plumbi i shkrirë. Muret e saje anësore janë punuar me gurë të gdhendur me kujdes	Atraksion kulturor	Vushtrri	Vushtrri
3	Hamami (banjoja publike)	Kjo banjë është ndërtuar në shekullin e XV. Përmendet në shumë dokumente të kohës osmane. Banjën publike e ka ndërtuar Gazi Ali Beu. Në hyrje të sajë gjendet një koridor 4X10m pastaj gjendet salla e madhe. Në këtë sallë frekuentuesit e hamamit lenin rrobat e palara. Aty ndodhën dy vaska guri ku shkarkohej uji i nxehtë i ardhur nga depoziti. Banja është ndërtuar me gurë e butë, ngjyrë të bardhë e të murosur me mjeshtri. Pullazi është i ndërtuar në formë kupole. Pjesa më hershme e hamamit është volumi përdhese më tre kupola të ulta ku është ambienti i ndërmjetëm, dy ambiente të larjes dhe depozita e ujit. Lokalet e banjës janë të shtruar me gurë mermeri të bardhë. Kazani për nxjerrjen e ujit gjendet në anën lindore të banjës. Ky vend quhet Cylhan. Uji nxehej me dru të cilat silleshin nga malet përreth Vushtrrisë. Në kupolat sipër banjës gjenden disa vrime të vogla në formë rrethi të mbuluara me çelq, të cilat kanë shërbyer për ndriçimin e lokaleve të brendshme me anë të rrezeve të diellit. Rëndësia kulturore historike, arkitektonike, hidraulike e kësaj banje është tepër e madhe, por kujdesi për të mungon	Atraksion kulturor	Vushtrri	Vushtrri
4	Kulla dhe Kompleksi "Azem e Shote Galica"	Azem Galica u lind me 10 Dhjetor 1889 ndërsa u vra me 15.07.1924 .Kulla dhe Kompleksi "Azem e Shote Galica"në Galicë u ndërtua në vitin 2013. Azem Bejta është Hero i kombit, luftëtar i paepur kundër pushtuesëve Austro hungarez dhe Mbretërisë SKS. Më 1918 intelektuale shqiptare nën udhëheqjen e Hoxhë Kadri Prishtinës formojnë Komitetin "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" me seli në Shkodër. Ky Komitet për t'u ardhur në ndihmë kryengritësve hartoj Programin prej 10 pikash dhe Azem Bejten e caktoj kryekomandant të çetave çlirimtare të cilat numëronin mbi dhjetë mijë luftëtare.	Atraksion kulturor	Galicë	Vushtrri

5	Sheshi dhe shtatorja “Hasan Prishtina”	Hasan bej Prishtina i njohur edhe si Hasan Prishtina apo Berisha u lind në Vuçitern, në vitin 1873, ndërsa u vra në Selanik, 13 gusht 1933. Ka qenë politikan shqiptar në Perandorinë Osmane, ndër krerët e disa kryengritjeve gjatë periudhës parlamentare osmane duke bërë që me Kryengritjen e vitit 1912 të fitonte autonominë e Vilajetit Shqiptar. Lufta Ballkanike nuk i la mundësi jetëgjatësisë arritjes së tij dhe pas pavarësisë së Shqipërisë u emërua ministër në qeverinë e parë dhe më pas kryeministër.	Atraksion kulturor	Vushtrri	Vushtrri
6	Shtëpia e ish Arkivit Historik	Arkivi Historik Komunal në Vushtrri është themeluar më 3 Mars 1968. Në fillim ka punuar në kuadër të “Kuvendit Komunal në Vushtrri”. Në vitet 1972-1980, ky shërbim i bashkëngjitet Arkivit Historik regjional në Mitrovicë.	Atraksion kulturor	Vushtrri	Vushtrri
7	Xhamia e Gazi Ali Beut	Xhamia e Gazi Ali Beut Sipas librit “Barbaria serbe mbi monumentet e kulturës Islame në Kosovë”, është ndërtuar në vitin 1410, kurse sipas pjesës dërrmuese të historianëve, është ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XV. Xhamia në fjalë kishte një arkitekturë interesante dhe me minare. Xhamia është dykatëshe e stilit Osman. Ajo gjendet pranë banjos Publike – Hamamit. Konsiderohet se ndërtues i kësaj xhamie ka qenë Gazi Ali Beu, i cili thuhet se e ka ndërtuar edhe Hamamin. Kjo Xhami, si pasojë e granatimeve të ushtrisë dhe policisë serbe në vitin 1999, ka pësuar shkatërrime në mure dhe minarja është rrëzuar tërësisht. Në oborret e kësaj Xhamie gjendej nishani – guri i varrit të Mustafë Beut, që ishte Sanxhakbe i parë i Sanxhakut të Vushtrrisë, i cili në të vërtetë ka qenë shqiptarë vendas. Oborri i Xhamisë Gazi Ali Beu ishte përplot me gurë varresh të punuara me gdhendje dhe mjeshtëri të rrallë. Kishte edhe gurë varresh me ngjyra të ndryshme.	Atraksion kulturor	Vushtrri	Vushtrri
8	Xhamia Karamanli	Kjo xhami u ndërtua në vitin 1675. Xhamia ka hajatin sa për tu falur dy safë (rrjeshta), e në fund të murit kanë qenë dollapët në të dy anët për lënien e këpucëve Kjo xhami është quajtur Xhamia e Plumbit, ngase ka qenë e mbuluar me plumb. Nga vjetërsia është ndërruar aluminiumi. Minarja së bashku me kulmin e xhamisë u shkatërruan nga bombardimet e forcave serbe më 06 prill 1999.	Atraksion kulturor	Vushtrri	Vushtrri
9	Shtëpia e Shaban Agë Haxhiut	Shtëpia e Shaban Agë Haxhiut në Vushtrri. Shaban aga ishte nga Makërmali i Drenicës, i cili u vendos në Vushtrri dhe kishte prona të mëdha bregut të Sitnicës. Shtëpia e Shaban Haxhiut është ndërtuar në shekullit XIX. Kjo shtëpi shquhet me arkitekturë popullore me elemente dekoruese gjeometrike, sidomos në dekorimet e dyerve ku paraqitet figura e diellit. Është monument unikat i arkitekturës popullore qytetare të shekullit XIX. Është e ndërtuar me themele nga guri, me mur nga tullat, me dritare të shumta, me dekorime përbrenda. Është i njohur edhe mulliri i Shaban Agës, i cili gjendej në breg të lumit Sitnica, aty ishte kopshti me pemë e perime. Ky mulli ka egzistuar deri në vitet e 60-ta të shek XX.	Atraksion kulturor	Vushtrri	Vushtrri

10	Shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit	Shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit. Një ndër monumentet më të komplekse arkitektonike të shtëpive në Vushtrri është edhe pallati, ose saraji (shtëpi e bukur) i Gjinollëve. Shtëpia e Mahmut agë Gjinollit është ndërtuar diku në fund të shek. XIX. Shtëpia kryesisht është e ndërtuar në stilin barok, por ka edhe elemente të tipit të shtëpive orientale. Në pjesën më të lartë të këtij pallati gjendet ora në formë harku, e cila ka funksionuar në favor të popullatës të cilët janë orientuar në kohë për qëllime praktike. Pozita e kësaj ndërtese është e kthyer kah lindja që s'është karakteristikë e ndërtesave tjera feudale (të të pasurve). Ky ndërtim është bërë me qëllim të dominimit të pamjes mbi qytetin, për një vëzhgim më të mirë mbi lëvizjet në qytet. Në kohën e perandorisë osmane në këtë shtëpi janë vendosur organet e pushtetit komunal (Beledije). Pas Luftës së dytë Botërore ka shërbyet si ambulance-spital, pastaj janë strehuar të varfërit, e së fundi me vendim të kuvendit komunal aty vendoset muzeu komunal Historik Etnografik. Monumenti-Shtëpia e Mahmut agës ka rëndësi të veçantë arkitektonike, historike e kulturore për Vushtrrinë.	Atraksion kulturor	Vushtrri	Vushtrri
11	Muzeu Historik Etnografik	Muzeu Historik Etnografik i Vushtrrisë. U themelua me vendim të kuvendit komunal të Vushtrrisë më 09.06.2005 Përkohësisht është i vendosur në lokalet e Shtëpisë së Kulturës "Hasan Prishtina. Muzeu përbëhet nga sektori i arkeologjisë, historisë, etnografisë, folklorit, kinotekës, fototekës dhe disa nënsektorëve. Në sektorin e arkeologjisë, ekspozatet i përkasin periudhëve të ndryshme historike duke filluar nga ato të qytetërimit Ilir, deri tek ato të periudhës së mesjetës së vonshme. Me synim që trashëgimia kulturore dhe historia të ruhen dhe mos të zhbëhen, duke ngërthyer këtu edhe ngjarje dhe figura historike në to, të cilat u përballën gjatë historisë me synim të krijimit të shtetit dhe pavarësisë në këtë muze gjetën vend edhe ekspozate historike: fotografi të personaliteteve të shquara në nivel komunal dhe kombëtar si: foto të Hasan Prishtinës, Ismail Qemalit, Azem e Shotë Galicës, foto të dëshmorëve të rënë në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës 1998- 1999 etj.	Atraksion kulturor	Vushtrri	Vushtrri
12	Muzeu Historik Etnografik i Vushtrrisë	Përkohësisht është i vendosur në lokalet e Shtëpisë së Kulturës "Hasan Prishtina", në një hapësirë prej dy dhomash: njëra e destinuar për personelin dhe tjetra për ekspozate. Në këtë periudhë të shkurtër, është arritur të grumbullohet një thesar i çmuar i artefakteve të kulturës materiale nga kjo trevë duke përfshirë: ekspozate arkeologjike, historike etnografike, si dhe duke bërë incizimin e trashëgimisë kulturore në terren. Muzeu përbëhet nga sektori i arkeologjisë, historisë, etnografisë, folklorit, kinotekës, fototekës dhe disa nënsektorëve.	Atraksion kulturor	Vushtrri	Vushtrri
13	Mulliri me ujë në fshatin Samadrexhë	Mulliri është i ndërtuar në vitin 1918, gjendet në hyrje të fshatit Samadrexhë. Mulliri është restauruar dhe shërben për bluarje dhe si atrakcion turistik.	Atraksion kulturor	Samadrexhë	Vushtrri
14	Shtegu për hecje dhe biçikleta	Ky shteg përshkon fshatërat: Sllakovc, Skromë, Boshlan, Gumnishtë deri në Bare e Bajgorë të komunës së Mitrovicës. Distanca nga Qyteti Vushtrrisë për në fshatin Sllakovc ku edhe fillon shtegu për këmbësor dhe biçikleta është rreth 16 km, ndërsa nga qyteti Mitrovicës për në fshatin Bajgorë ku edhe përfundon shtegu, është rreth 20 km.	Atraksion natyror/artificial	Bjeshkët e Shalës së Bajgorës	Vushtrri